

GARANCIA E KUFIZUAR

Të drejtat shtesë sipas Ligjeve për konsumatorin. Nëse JU jeni një konsumator, JU mund të keni të drejta ligjore (të njohura me ligj) shtesë përveç atyre të përcaktuara në këtë Garanci të kufizuar (siç janë ligjet e konsumatorit në vendin ku JU jetoni ("**Të drejtat e konsumatorit**"). Garancia e kufizuar përcakton situata të caktuara në të cilat BlackBerry do të sigurojë ose jo një zgjidhje për pajisjen BlackBerry. Kjo Garanci e kufizuar nuk kufizon ose përjashton asnjë nga të drejtat TUAJA të konsumatorit lidhur me pajisjen BlackBerry.

Mbulimi prej garancisë së prodhuesit. Kjo Garanci e kufizuar e prodhuesit përcakton përgjegjësitë e garancisë të BlackBerry Limited dhe filialeve të tij ("**BlackBerry**") në lidhje me produktet harduer dhe aksesorët e markës BlackBerry të prodhuar nga ose për llogari të BlackBerry ("Pajisja **BlackBerry**"). BlackBerry garanton blerësin fillestar përdorues të një pajisjeje të re BlackBerry ("**JU**"), se pajisja BlackBerry do të jetë pa defekte në materiale dhe punëtori sipas përdorimit normal për një periudhë që fillon nga data e blerjes fillestare nga JU dhe duke vazhduar për periudhën e mëposhtme të specifikuar kohore për çdo lloj të aplikueshëm pajisjeje BlackBerry ("**Periudha e garancisë**"). Kjo Garanci e kufizuar nuk është e transferueshme prej JUSH.

(i) Për një telefon smartphone BlackBerry portativ, Periudha e garancisë është një (1) vit. Për të mësuar se si të merrni ndihmën e klientit për pajisjen tuaj BlackBerry, ju lutemi kontaktoni shitësin prej të cilit JU keni blerë pajisjen BlackBerry.

(i) Për një telefon smartphone BlackBerry Porsche Design, Periudha e garancisë është dy (2) vjet. Ju lutemi kontaktoni një përfaqësues të BlackBerry - informacioni i kontaktit mbi garancinë mund të gjendet në faqen www.blackberry.com/gettingstarted.

(i) Për një tabletë BlackBerry, Periudha e garancisë është një (1) vit. Ju lutemi kontaktoni një përfaqësues të BlackBerry - informacioni i kontaktit mbi garancinë mund të gjendet në faqen www.blackberry.com/playbookwarranty.

(iv) Për aksesorët BlackBerry që përshijnë komponentë të harduerit dhe softuerit (për shembull: pajisjet Bluetooth, lexuesit e kartave smart dhe altoparlantët për vendosje në strehën e diellit), Periudha e garancisë është një (1) vit. Ju lutemi kontaktoni shitësin prej të cilit JU keni blerë pajisjen BlackBerry.

Mund të zbatohen përjashtime ndaj Garancisë së kufizuar për modele të caktuara të pajisjes BlackBerry ose për disa vende – ju lutemi referojuni Shtojcës 1 të kësaj Garancie të kufizuar. Për pajisjet BlackBerry të ripaketuara nga ose për llogari të BlackBerry, do të zbatohet pjesa e mbetur e periudhës së garancisë (nëse ka) për këtë pajisje BlackBerry të ripaketuar.

Gjatë Periudhës së garancisë, nëse BlackBerry konstaton se pajisja BlackBerry është me defekt dhe mbulohet nga kjo Garanci e kufizuar, sipas gjykimit të vet ekskluziv dhe absolut BlackBerry mund të veprojë si më poshtë:

- (i) riparon me pjesë të reja ose të pakushtëzuara pjesën me defekt të pajisjes BlackBerry pa pagesë për JU;
- (ii) zëvendëson pajisjen defektoze BlackBerry pa pagesë për JU me një produkt po aq të ri ose të ripaketuar; ose
- (iii) nëse BlackBerry nuk është në gjendje të riparohet ose zëvendësojë pajisjen BlackBerry siç përcaktohet në pikat (i) ose (ii), ju rimbursen JUVE çmimin neto të blerjes që keni paguar për pajisjen BlackBerry.

Nëse pajisja BlackBerry riparohet ose zëvendësohet nga ose për llogari të BlackBerry gjatë Periudhës së garancisë, Periudha e garancisë për pajisjen e riparuar ose të zëvendësuar të BlackBerry do të skadojë pas skadimit të Periudhës fillestare të garancisë (përveçse në masën ku BlackBerry kërkohet shprehimisht nga ligji që t'ju sigurojë JUVE sipas ligjit një Periudhë garancie më të gjatë për pajisjen e riparuar ose zëvendësuar BlackBerry). Çdo shërbim garancie ose ndihmë e dhënë nga ose për llogari të BlackBerry sipas kësaj Garancie të kufizuar, kushtëzohet me kthimin e pajisjes SUAJ BlackBerry të një ofruesi i autorizuar shërbimi i BlackBerry (siç përcaktohet më poshtë nën "Kthimi i pajisjes BlackBerry"). Kur JU ktheni mbrapsht një pajisje BlackBerry sipas kësaj Garancie të kufizuar dhe marrni një pajisje BlackBerry zëvendësuese, produkti që JU kthyer bëhet pronë e BlackBerry dhe produkti i zëvendësuar bëhet JUAJI. Kur ju jepet një rimbursim sipas kësaj Garancie të kufizuar, JU do të ktheni pajisjen tuaj BlackBerry pranë BlackBerry dhe pajisja BlackBerry e kthyer bëhet pronë e BlackBerry.

Përjashtimet dhe kufizimet e garancisë. Garancia e kufizuar nuk aplikohet (siç përcaktohet nga BlackBerry):

- (i) për pjesët e konsumueshme të një pajisjeje BlackBerry, si për shembull bateritë dhe veshja mbrojtëse, të cilat janë projektuar që të prishen me kalimin e kohës, me përjashtim të rasteve kur dëmi është shkaktuar nga një defekt material ose nga punëtoria;
- (ii) për vjetrimin dhe konsumimin normal të një pajisjeje BlackBerry;
- (iii) nëse pajisja BlackBerry është hapur, modifikuar ose riparuar nga dikush tjetër që nuk është i autorizuar nga BlackBerry;
- (iv) nëse numri serial i pajisjes BlackBerry, numri IMEI ose identifikuesi tjetër janë dëmtuar ose hequr;
- (v) për një pajisje BlackBerry ku dëmtimi, keqfunksionimi ose defekti shkaktohet nga dhe/ose si rezultat i:
 - (a) keqpërdorimit, lagështisë ose lëngjeve, afërsisë ose ekspozimit ndaj nxehtësisë, aksidenteve, abuzimit, neglizhencës apo keqpërdorimit;
 - (b) përdorimit të pajisjes BlackBerry së bashku me aksesore, produkte, shërbime, softuerë, aplikacione apo pajisje ndihmëse ose periferike të pa miratuara apo të dhëna shprehimisht nga BlackBerry posaçërisht për përdorim me modelin TUAJ të veçantë të pajisjes BlackBerry;

(c) çdo gjë që nuk është për faj të vetë pajisjes BlackBerry; ose

(d) funksionimit ose përdorimit të pajisjes BlackBerry ndryshe nga udhëzuesi përkatës i instalimit ose dokumentacioni standard i përdoruesit i përgatitur dhe dhënë nga BlackBerry, duke përfshirë çdo udhëzim sigurie dhe përdorimi të disponueshëm në <http://docs.blackberry.com> ose Marrëveshjen e licencës për zgjidhjet e BlackBerry të disponueshme në <http://us.blackberry.com/legal/bbsla.jsp>;

(v) për dëmtimin e sipërfaqes së pajisjes BlackBerry, duke përfshirë, por pa u kufizuar me plasaritjet, ciflosjet ose gërvishtjet;

(vii) për çdo pajisje, tabletë apo harduer ndryshe nga pajisja BlackBerry siç përkufizohet në këtë Garanci të kufizuar – për shembull, nuk zbatohet për kartat e jashtme SIM që merrni me blerjen TUAJ ose për gjithçka që nuk ka markën BlackBerry dhe nuk është prodhuar nga ose për llogari të BlackBerry; ose

(viii) nëse JU nuk jeni në gjendje të paraqisni provë të blerjes që vërteton se JU jeni blerësi fillestare i pajisjes BlackBerry dhe datën e vendin e blerjes fillestare.

Kjo Garanci e kufizuar është garanci vetëm për harduerin që kufizohet me pajisjen BlackBerry dhe nuk mbulon asnjë softuer të dërguar, ngarkuar paraprakisht ose shpërndarë nga BlackBerry apo një palë e tretë, edhe nëse softueri është i paketuar ose shitet me pajisjen BlackBerry, ose disponohet për BlackBerry në një moment të mëvonshëm. Marrëveshjet e licencës së softuerit zbatohen për përdorimin TUAJ të softuerit që shoqëron pajisjen BlackBerry. Licenca e softuerit për softuerin e regjistruar me patentë nga BlackBerry, që është dërguar me pajisjen BlackBerry përshtrohet në marrëveshjen përkatëse të licencës së softuerit të BlackBerry.

Krijimi i një kopjeje rezervë të të dhënave. JU duhet të krijoni rregullisht një kopje rezervë të të dhënave të pajisjes SUAJ BlackBerry, të softuerëve, aplikacioneve dhe informacionit, si një masë mbrojtëse kundrejt problemeve të mundshme operacionale, përfshirë edhe përpara kthimit të pajisjes BlackBerry. Krijimi i kopjeje rezervë të të dhënave është përgjegjësia JUAJ dhe nuk është përgjegjësia e BlackBerry, shitësit përmes të cilit keni blerë pajisjen BlackBerry, ose e ofruesve të autorizuar të shërbimit nga të cilët JU keni marrë shërbim, riparim ose zëvendësim të pajisjes BlackBerry, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, të dhënat e humbura apo të dëmtuara nga përdorimi i softuerit të sinkronizimit. JU LUTEM FSHINI ÇDO PAJISJE PERIFERIKE OSE MEMORIE DHE/OSE NDONJË INFORMACION PERSONAL OSE KONFIDENCIAL PËRPARA SE TË KTHENI PAJISJEN TUAJ BLACKBERRY. GJATË SHËRBIMIT, RIPARIMIT OSE ZËVENDËSIMIT, NË PAJISJEN TUAJ BLACKBERRY MUND TË FSHIHEN DHE/OSE RIFORMATOHEN APO KONFIGUROHEN PËRMBAJTJE, NJËSOJ SIÇ E BLETË FILLIMISHT (DUKE IU NËNSHTRUAR PËRDITËSIMEVE DHE PËRMIRËSIMEVE TË SOFTUERËVE NË ATË PERIUDHË, QË I NËNSHTROHEN MARRËVESHJES SË LICENCËS SË SOFTUERIT PËR ZGJIDHJEN E BLACKBERRY) DHE MUND TË HIQEN PAJISJE PERIFERIKE OSE MEMORIE DHE TË MOS JU KTHEHEN. Për të qenë më të qartë, kjo Garanci e kufizuar nuk mbulon kopjet rezervë, rikuperimin ose instalimin e të dhënave TUAJA, softuerëve ose aplikacioneve në pajisjen BlackBerry.

Kthimi i pajisjes BlackBerry. Kjo Garanci e kufizuar ju jepet JUVE nga BlackBerry Limited. Për të përcaktuar nëse pajisja JUAJ BlackBerry kërkon shërbimin e garancisë dhe për të marrë udhëzime se si ta ktheni pajisjen TUAJ BlackBerry, ju lutemi kontaktoni Kontaktin përkatës të Garancisë për pajisjen BlackBerry në fjalë të përshkruar në tabelën e mëposhtme të Mbulimi prej garancisë së prodhuesit.

Kur kontaktoni me BlackBerry ose një ofrues të autorizuar të shërbimit të BlackBerry përmes telefonit, mund të tarifojeni. JUVE mund t'ju kërkohet të ndihmoni në diagnostikimin e ndonjë problemi të pajisjes SUAJ BlackBerry dhe/apo të jepni provë blerjeje që vërteton se JU jeni blerësi fillestar i pajisjes BlackBerry, si dhe datën dhe vendin e blerjes fillestare. Opsionet e shërbimit të garancisë, koha e pritjes së përgjigjes dhe tarifat (nëse ka) mund të ndryshojnë sipas vendit. **NËSE PAJISJA JUAJ BLACKBERRY KTHEHET GJATË PERIUdhës Së GARANCISË, POR PAJISJA JUAJ BLACKBERRY NUK MBULOHEK nga KJO GARANCI E KUFIZUAR, MUND TË ZBATOHEN KUSHTE DHE PAGESA PËR ÇDO RIPARIM OSE PËRPUNIM TË KRYER.** NËSE NUK JETONI NË VENDIN KU JU ËSHTË SHITUR FILLIMISHT PAJISJA BLACKBERRY ATËHERË:

(A) RIPARIMI OSE SHËRBIMI I GARANCISË MUND TË MOS JETË I MUNDUR;

(B) JUVE MUND T'JU KËRKOHET TË PRANONI KUSHTE DHE /OSE TË PAGUANI KOSTO TË CAKTUARA (DUKE PËRFSHIRË, POR PA U KUFIZUAR ME PAGESA TRANSPORTI DHE PËRPUNIMI); DHE

(C) PËRFUNDIMI I RIPARIMEVE APO SHËRBIMEVE TË GARANCISË, NËSE JANË TË MUNDSHME, MUND TË ZGJASIN MË SHUMË SE NORMALISHT.

Zgjidhjet ekskluzive. PËRVEÇSE DERI NË MASËN QË BLACKBERRY NDALOHEK SHPREHIMISHT nga LIGJI (DUKE PËRFSHIRË FAKTIN NËSE KENI TË DREJTA KONSMATORI PËRVEÇ KËSAJ GARANCIE TË KUFIZUAR) nga KUFIZIMI OSE PËRJASHTIMI I ZGJIDHJEVE TUAJA NË LIDHJE ME PAJISJEN TUAJ BLACKBERRY, KJO GARANCI E KUFIZUAR PËRCAKTON ZGJIDHJET TUAJA EKSKLUZIVE PËR PAJISJEN TUAJ BLACKBERRY DHE TË GJITHA GARANCITË E TJERA, KUSHTET, OSE GARANTIMET E ÇDO LLOJI, QOFTË TË SHPREHURA OSE TË NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË, POR PA U KUFIZUAR ME, GARANCITË E TREGTUESHMËRISË, CILËSISË SË KËNAQSHME DHE/OSE PËRSHTATSHMËRISË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR, HIDHEN POSHTË DHE NUK DO TË ZBATOHEN OSE NUK DO TË KENË EFEKT.

Kufizimet e përgjegjësisë. PËRVEÇSE DERI NË MASËN QË BLACKBERRY NDALOHEK SHPREHIMISHT nga LIGJI (DUKE PËRFSHIRË FAKTIN NËSE KENI TË DREJTA KONSMATORI PËRVEÇ KËSAJ GARANCIE TË KUFIZUAR) OSE NËSE NJË VEND, SHTET APO PROVINÇË KU JU JETONI NUK LEJON PËRJASHTIMIN OSE KUFIZIMIN E DËMEVE AKSIDENTALE OSE RRJEDHIMORE, NË ASNJË RAST BLACKBERRY APO DIKUSH TJETËR QË VEPRON PËR LLOGARI TË OSE ME BLACKBERRY (DUKE PËRFSHIRË, POR PA U KUFIZUAR, NË LIDHJE ME PRODHIMIN, FURNIZIMIN, SHPËRNDARJEN, SHITJEN, RIPARIMIN OSE KTHIMIN E PAJISJES BLACKBERRY) NUK DO TË JETË PËRGJEGJËS PËR NDONJË HUMBJE APO DËMTIM RRJEDHIMOR TË ÇFARËDO LLOJI (DUKE PËRFSHIRË, POR PA U KUFIZUAR ME, DËMET PËR HUMBJE TË FITIMEVE,

NDËRPRERJE TË BIZNESIT, HUMBJE OSE DËMTIM TË INFORMACIONIT (DUKE PËRFSHIRË TË DHËNAT), OSE HUMBJE TË TJERA MONETARE) QË LINDIN SI RRJEDHOJË E PËRDORIMIT OSE PAMUNDËSISË SË PËRDORIMIT TË PAJISJES BLACKBERRY, EDHE NËSE BLACKBERRY APO KUSHDO TJETËR QË VEPRON PËR LLOGARI TË OSE ME BLACKBERRY ËSHTË KËSHILLUAR PËR MUNDËSINË E KËTYRE DËMEVE. KY KUFIZIM SYNOHET TË ZBATOHET DHE ZBATOHET PA MARRË PARASYSH FAKTIN NËSE DËME TË TILLA JANË DEKLARUAR APO JO, VERIFIKUAR APO PASQYRUAR NË NJË MASË APO REKLAMIM DËMTIMI, KONTRATË, NË GARANCI OSE NËN NDOJË TEORI TJETËR LIGJORE. PËRGJEGJËSIA E BLACKBERRY, DHE KUJTO QË VEPRON PËR LLOGARI TË OSE ME BLACKBERRY, NDAJ JUSH PËR HUMBJE OSE DËME QË LINDIN NËN KËTË GARANCI TË KUFIZUAR, NUK DO TË TEJKALOJË NË TËRËSI ÇMIMIN NETO TË BLERJES QË JU KENI PAGUAR PËR PAJISJEN BLACKBERRY OSE KOSTON E ZËVENDËSIMIT TË PAJISJES BLACKBERRY NË FJALË, CILADO TË JETË MË E MADHE. Sa u përmend më lart, gjithsesi, nuk do të kufizojë në asnjë mënyrë ndonjë detyrim në lidhje me vdekjen ose lëndimin trupor apo detyrim ligjor për veprime ose mosveprime të qëllimshme dhe neglizhencë të lartë.

Ligjet që drejtojnë kontratën. LIGJET E VENDIT, SHTETIT, PROVINÇËS OSE JURIDIKSIONIT SIÇ PARAQITEN NË KËTË PARAGRAF DO TË DREJTOJNË:

(A) KËTË GARANCI TË KUFIZUAR DHE INTERPRETIMIN, ÇDO SHKELJE DHE VLEFUSHMËRI TË KËSAJ GARANCIE TË KUFIZUAR, DHE

(B) ÇDO PRETENDIM, MOSMARRËVESHJE, OSE DEBAT (QOFTË NË KONTRATË, SHKELJE CIVILE, OSE NDRYSHJE, QOFTË PARA-EKZISTUES, I TASHËM OSE I ARDHSHËM, DHE DUKE PËRFSHIRË PRETENDIMET LIGJORE, TË LIGJIT TË PËRGJITHSHËM DHE PRETENDIMET E PAANSHME) MES JUSH DHE BLACKBERRY QË LINDIN NGA OSE NË LIDHJE ME KËTË GARANCI TË KUFIZUAR.

LIGJET NË FUQI TË VENDIT, SIÇ PËRCAKTOHEN NË TABELËN E MËPOSHTME, DO TË ZBATOHEN NË VARËSI TË VENDIT KU JU BANONI DHE PËRJASHTOJNË ÇDO ENT LIGJOR QË DREJTON KONFLIKTET LIGJORE.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE / ARBITRAZHI. ÇDO MOSPAJTIM OSE MOSMARRËVESHJE QË LIND NGA OSE NË LIDHJE ME KËTË GARANCI TË KUFIZUAR DUHET TË ZGJIDHET ME ARBITRAZH PËRFUNDIMTAR DHE DETYRUES NË PËRPUTHJE ME RREGULLAT E ARBITRAZHIT NË TABELËN MË POSHTË BAZUAR NË VENDIN KU BANONI: (I) VENDI I ARBITRAZHIT DUHET TË JETË VENDNDODHJA E ARBITRAZHIT DHE ARBITRAZHI DUHET TË KRYHET NË GJUHËN ANGLEZE; (II) NUMRI I ARBITRUESVE DUHET TË JETË NJË (1); DHE (III) ARBITRUESI DUHET TË EMËROHET NË PËRPUTHJE ME RREGULLAT E ARBITRAZHIT NË FJALË. TË GJITHA ÇËSHTJET NË LIDHJE ME ÇDO ARBITRAZH NËN KËTË GARANCI TË KUFIZUAR DUHET TË MBAHEN NË FSHEHTËSINË MË TË RREPTË NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUESHME NGA LIGJI. ASNJË MOSMARRËVESHJE NDËRMJET PALËVE, OSE QË PËRFSHIN ÇDO PERSON TJETËR PËRVEÇ JUSH, NUK MUND TË BASHKOHET OSE TË KOMBINOHET SË BASHKU, PA MIRATIMIN PARAPRAK ME SHKRIM TË BLACKBERRY.

Nëse JU banoni në Evropë, Lindjen e Mesme ose Afrikë, kjo Garanci e kufizuar do të drejtohet nga ligjet e Anglisë dhe Uellsit dhe JU bini dakord që arbitrazhi të kryhet në Londër, Angli, në përputhje me Gjykatën Londineze të Rregullave të Arbitrazhit Ndërkombëtar. Nëse JU jeni banues në Azi, kjo Garanci e kufizuar, do të drejtohet nga ligjet e Nju Jorkut dhe JU bini dakord që arbitrazhi të kryhet në Nju Jork, NY, SHBA, në përputhje me Gjykatën Londineze të Rregullave të Arbitrazhit Ndërkombëtar. Nëse JU jeni banues në Amerikën e Veriut apo Jugut, kjo Garanci e kufizuar, do të drejtohet nga ligjet e Nju Jorkut dhe JU bini dakord që arbitrazhi të kryhet në Nju Jork, NY, SHBA, në përputhje me rregullat e Arbitrazhit Tregtar të Shoqatës Amerikane të Arbitrazhit.

Privatësia. Informacionet e klientit të mbledhura nga BlackBerry do të përdoren, përpunohen dhe bëhen të ditura në përputhje me Politikën e Privatësisë së BlackBerry (e disponueshme në faqen <http://www.blackberry.com/legal/privacy.shtml>) për të kryer shërbimet e garancisë të përshkruara në këtë Garanci të kufizuar. Kjo mund të përfshijë marrjen e informacionit TUAJ dhe të pajisjes BlackBerry nga ofruesit e shërbimeve, shitësit, tregtuesit dhe shpërndarësit e përfshirë në zinxhirin e kujdestarisë së pajisjes BlackBerry sipas të cilës kryen shërbimet e garancisë dhe transferimin e informacionit TUAJ dhe të pajisjes BlackBerry te filialet e BlackBerry ose ofruesit e shërbimeve të BlackBerry.

Të ndryshme. Nëse ka ndonjë konflikt midis kësaj Garancie të kufizuar dhe ndonjë garancie tjetër që ju është ofruar JUVE, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, ambalazhimin e pajisjes BlackBerry, dispozitat e kësaj Garancie të kufizuar do të zbatohen nga BlackBerry në masën e këtij konflikti. Nëse ndonjë kusht, dispozitë ose nënparagraf i kësaj Garancie të kufizuar konsiderohet për të qenë i anuluar, jo i ligjshëm apo i pazbatueshëm, nuk do të preken vlefshmëria apo zbatueshmëria e pjesës së mbetur së këtij kushti, dispozite apo nënparagrafi dhe kjo Garanci e kufizuar.